



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:008459
Datë: 05.06.2024
Numri i dokumentit: 05782084

C-IV-14-7556
Parashtruesi i kërkesës

S S nga Prishtina.

kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH “Banka Themelore e Kosovës” në likuidim),
Rr. ‘Dritan Hoxha’ nr.55. Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 5 qershor 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN125-00749 datë 3 dhjetor 2014.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 19 dhjetor 2014, pranë DHPGJS, ankuesi parashtror një kërkesë, të emërtuar padi, për rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN125-0749 datë 3 dhjetor 2014 (tani e tutje Vendimi), me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës , për periudhë të pacaktuar , në shumë prej 64,189.90 (gjashtë katër një tetë nëntë zero) Euro, ndaj NSH “Banka Themelore e Kosovës” (në likuidim).

Ankuesi kundërshtoj Vendimin e AL në kuptim të aplikimit të dispozitave ligjore, nenin 608, të Ligjit për punën e bashkuar, duke konsideruar këtë ligj si të pa-aplikueshëm në Kosovë.

Ankuesi konsideron se kërkesën e tij kreditore e ka parashtruar në kohë, gjithnjë duke ju referuar njoftimit të AKP mbi procedurën e likuidimit të NSH si dhe mundësisë së parashtrimit të kërkesave kreditore.

Tutje, ankuesi pohon se për shkak të masave të dhunshme të aplikuara kur edhe është larguar nga puna, në kohën për të cilën kërkohet kompensimi, nuk ka mundur të kërkojë kompensimin e të ardhurave.

Nga gjitha arsyet propozon që kërkesa e tij kreditore, mbi kompensimin e të ardhurave personale në shumën e kërkuar dhe atë periudhën nga vitit 1991 gjer 1999, të aprovohet.

Kërkesës për rishikim i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 5 dhjetor 2023, parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP mbështeti Vendimin e AL si të bazuar në dispozitat ligjore. AKP tutje pohoj se kërkesa për rishikim – ankesa, nuk përmban argumentet e saj ligjore ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP gjithashtu theksoj se kërkesa kreditore, në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP, është e pabazuar duke ju referuar dispozitave të nenit 40.1.6.2. Nga gjitha AKP propozoj që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Përgjigja e AKP, me urdhër të gjykatës, ju dorëzua ankuesit me 5 shkurt 2024.

Ankuesi nuk parashtroj përgjigje.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim - ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi me anë të kërkesës së tij për rishikim-ankesës, ka kërkuar rishikimin e Vendimit të AL, dhe kërkoj pagat e papaguara, në shumën e kërkuar si dhe për periudhën nga viti 1991 në vitin 1999.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtresat e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Edhe nga vetë pohimet e ankuesit, i njëjti nuk ishte i punësuar pranë NSH gjatë periudhës për të cilën kërkon kompensimin e të ardhurave personale dhe në anën tjetër pavarësisht pohimeve të tij i njëjti nuk ka parashtuar ndonjë vendim gjyqësor apo edhe vendim të ndonjë organi tjetër kompetent nga i cili do të vërtetohej se i njëjtit i është njohur e drejta nga marrëdhënia e punës gjatë kësaj periudhe, 1991-1999.

Dispozitat ligjore lidhur me kompensimin, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2. parashihen kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarjes, apo në lidhje me veprimin

e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Nga dispozitat e lartë cekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar;
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL; dhe
- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7 parashihet përmbushja e kërkesave përfshirë kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë

Ankuesi, nga dëshmitë e parashtruara, nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 por edhe paragrafit 1.7 (kërkesat e pasiguruara) të po të njëjtit nen, si edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Taksa Gjyqësore:

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar